

FSDK – Linja e Dytë e Hapur Kreditore

Shteti:	KOSOVË
Numri i Projektit:	48797
Spektori afarist:	Kredi jo-depozitore (jo-bankare)
Lloji i Njoftimit:	SHTETËROR
Kategoria Mjedisore:	FI
Data e Aprovimit nga Bordi:	14 Dhjetor 2016
Statusi:	Aprovuar nga Bordi
DPP e Hapur:	

Përshkrimi i Projektit

BERZH është duke ofruar një linjë të hapur kreditore në vlerë prej 24 milion Eurosh për Fondin për Sigurimin e Depozitave të Kosovës (FSDK), të garantuar plotësisht nga Republika e Kosovës.

Linja e hapur kreditore është përshtatur për nevojat e FSDK dhe do të ofrohet në tri transhe gjatë viteve 2016-2020. Transhi i parë zotohet në kohën e nënshkrimit ndërsa dy transhet e tjera janë të pa zotuara. Linja e hapur kreditore është paraparë që të jetë në dispozicion sipas disa kushteve paraprakisht të dakorduara me qëllim të vendosjes në dispozicion të fondeve për kompensimin e depozituesve të siguar. Ky produkt do t'i mundësojë FSDK që të mbajë mbulueshmërinë e depozitave totale të siguruara në nivelet përkatëse sipas praktikave të mira ndërkombëtare.

Linja e hapur kreditore është pjesë e mekanizmave të FSDK-së për financim emergjent dhe gjithashtu do të ndihmojë FSDK-në që të rrisë mbulueshmërinë e depozitave të siguruara në faza, siç është paraparë në Ligjin mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Sigurimin e Depozitave nga shuma aktuale prej 4,000 Euro në 5,000 Euro në vitin 2018.

Ndikimi në Tranzicion

Linja kreditore do të përmirësojë stabilitetin dhe besimin në sektorin bankar në Kosovë me rritjen e limitit të sigurimit të depozitave individuale.

Një skemë e zhvilluar dhe stabile për sigurimin e depozitave, është faktor kyç për funksionimin e mirë dhe efikas të tregut bankar. Duke u ofruar depozituese sigurim të depozitave të tyre, FSDK kontribuon në stabilitetin financiar dhe ndikon në rritjen e besimit në bankat lokale. Fondet efikase për sigurimin e depozitave gjithashtu i inkurajojnë amvisëritë që të depozitojnë mjetet e tyre financiare në këto banka dhe zvogëlojnë mundësinë e mbingarkesës së bankave në kohë krize.

Përmes mbështetjes që do t'i jepet FSDK me anë të linjës së propozuar kreditore, BERZH do të kontribuojë më tutje në zhvillimin e infrastrukturës financiare në Kosovë, rritjen e besimit në sistemin bankar dhe mbrojtjen e depozituesve të vegjël në aspekt afatgjatë. Ky projekt gjithashtu mund të ndikojë pozitivisht në disponueshmërinë e fondeve dhe rrjedhimisht, rritjen e kapacitetit kredi-dhënës të sektorit bankar.

Informata për Klientin

FONDI PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE TË KOSOVËS

FSDK është institucion i pavarur publik i themeluar në Qershor 2011 sipas Ligjit mbi Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë.

Fondi ka autonomi operacionale dhe administrative dhe funksionon jashtë strukturave Qeveritare të Kosovës dhe shërbimit civil në Kosovë. Objektivi i Fondit është mbrojtja e depozituesve të vegjël nga humbjet në rast të dështimit të bankave si dhe mbështetja e Bankës Qendrore të Kosovës në arritjen e objektivave të saj për zhvillimin e një sistemi financiar të shëndoshë, solvent, efikas, stabil dhe të bazuar në ekonominë e tregut.

Përmbledhje Financiare e BERZH

24,000,000.00 Euro

1. 14 milion Euro të zotuar në kohën e nënshkrimit;
2. Deri në 6 milion Euro të pa zotuar dhe që do të bëhen të disponueshme në vitin 2018
3. Deri në 4 milion Euro të pa zotuar dhe që do të bëhen të disponueshme në vitin 2020

Kosto Totale e Projektit

24,000,000.00 Euro

Përmbledhja e Ndikimit Mjedisor dhe Social

Projekti është kategorizuar FI. Nuk ka ndikime negative mjedisore dhe/ose sociale që ndërlidhen me aktivitetet e FSDK; prandaj FSDK nuk obligohet të miratojë sistemet e menaxhimit mjedisor dhe social sipas PR9. Rreziqet e vetme mjedisore dhe sociale mund të ndërlidhen me punën (PR2) dhe shëndetin dhe sigurinë në punë (PR4) lidhur me menaxhimin e personelit të FSDK. Njëlloj sikurse më të gjithë klientët e tjerë të BERZH, FSDK duhet të zbatojë PR2 dhe PR4 të Bankës.

Bashkëpunimi Teknik

Nuk aplikohet

Informatat Kontaktuese të Kompanisë

Fondi për Sigurimin e Depozitave të Kosovës

0038138610355

www.fsdk.org

Rruga Pashko Vasa, PN, Kati 1 #Qyteza Pejton# Prishtinë, 10000 Kosovë

Mundësitë Afariste

Për mundësi afariste ose prokurime, kontaktoni kompaninë kliente.

Pyetjet e Përgjithshme

Pyetjet për projektet e BERZH që nuk ndërlidhen me prokurime:

Tel: +44 20 7338 7168; Faks: +44 20 7338 7380

Email: projectenquiries@ebrd.com

Politika e Informimit Publik (PIP)

PIP rregullon mënyrën e shpalosjes së informacionit nga BERZH dhe konsultimit me akterët përkatës për rritjen e vetëdijesimit dhe kuptimit lidhur me strategjitë, politikat dhe veprimtarinë e saj.

[Teksti i PIP](#)

Mekanizmi për Ankesa për Projekte (MAP)

BERZH ka krijuar Mekanizmin për Ankesa për Projekte (MAP) me qëllim që shqyrtimit të pavarur të ankesave nga një ose më shumë persona ose nga organizatat e ndryshme lidhur me projektet e financuara nga Banka dhe që pretendohet se kanë shkaktuar, ose kanë mundësi të shkaktojnë, dëme.

[Rregullat e Procedurës për MAP](#) | [Versioni në gjuhën Ruse](#)

Çdo ankesë që bëhet në kuadër të MAP duhet të dorëzohet jo më vonë se 12 muaj pas shpërndarjes së fundit të fondeve nga BERZH. Për qëllime të ankesës mund të kontaktoni zyrtarin për MAP (në email adresën pcm@ebrd.com) ose zyrën përkatëse vendore të BERZH për mbështetje nëse nuk jeni të sigurt për periudhën kohore brenda të cilës mund të bëhet ankesa.